



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 285 prot.

Tiranë, më 13. 02. 2024

V E N D I M

Nr. 43, datë 13. 02. 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 247, datë 16.11.2023, të S. Ç., kundër Mjekëve Okulist të Spitalit Rajonal Korçë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të *aftësisë së kufizuar dhe gjendjes shëndetësore*¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, S. Ç. ka parashtruar ndër të tjera se prej rreth 20 vitesh është trajtuar me pagesë paaftësie, me Status Verbërie, me diagnozë të lindur N....., H..... et A.....

Në muajin prill 2023, ankuesi është paraqitur pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë për të kryer vizitën e përvitshme, lidhur me rifreskimin e dokumentacionit për përfitimin e statusit të verbërisë. Komisioni i mjekëve okulistë pranë Shërbimit Okulistik pas vizitës së bërë, e kanë pajisur ankuesin me Epikrizën përkatëse për efekt KEMP-i. Sipas tij, ky dokument lëshohet vetëm një herë në vit nga komisioni i sipërcituar.

Me këtë dokument, në muajin prill 2023, është paraqitur pranë Mjekëve Okulistë të Spitalit Rajonal Korçë, për të vijuar procedurat e mëtejshme për përfitimin e statusit të verbërisë. Nga ana e tyre është bërë me dije se nuk mund ta përfitojë pagesën e verbërisë për një periudhë 6 mujore pasi rezulton se ka qenë i siguruar.

¹ Referuar Epikrizës së lëshuar nga Shërbimi Okulistikë i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë dhe Librezës së Verbërisë Nr. 09171, datë 07.07.2020, Lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror subjekti ankues i përket kategorisë së të verbëve të grupit të II-të.

Në muajin nëntor 2023, pasi ka kaluar afati 6 mujor, është paraqitur sërish pranë Mjekëve Okulistë të Spitalit Rajonal Korçë për të marrë Fletë drejtimin për KEMP, duke depozituar epikrizën e Komisionit të Mjekëve të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, por është refuzuar përsëri. Në këtë rast, nga ana e mjekëve të Spitalit Rajonal Korçë, është bërë me dije se dokumenti i lëshuar nga ana e Mjekëve të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë duhet rifreskuar.

Sa më sipër, është drejtuar sërish pranë Shërbimit Okulistikë, të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për të rifreskuar Epikrizën sipas udhëzimeve të Mjekëve Okulistë të Spitalit Rajonal Korçë, por nga ana e tyre është bërë me dije se ky dokument lëshohet vetëm një herë në vit dhe nuk mund ta pajisin me një tjetër pa përfunduar afati 1 vjeçar. Në këto kushte, ankuesi thekson se Mjekët Okulistë të Spitalit Rajonal Korçë, e kanë vënë në pozita diskriminuese për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes shëndetësore, duke mos i njohur Epikrizën e lëshuar nga Shërbimi Okulistikë, i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe në këtë mënyrë duke e penalizuar për përfitimin e pagesës së verbërisë.

Sakaq, S. Ç., ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës, të konstatojë diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar nga ana e Mjekëve Okulistë të Spitalit Rajonal Korçë dhe marrjen e masave për zgjidhjen e situatës në të cilën ndodhet.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën Nr. 1288/1 prot., datë 22.11.2023, i është drejtuar Spitalit Rajonal Korçë, duke kërkuar informacion sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Me shkresën² nr. 1874 prot., datë 04.12.2023, Spitali Rajonal Korçë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë, sapo ka marrë dijeni në lidhje me shkresën tuaj, ka marrë kontakt me mjekun Specialist Okulist Dr. A. K. i cili është mjeku që ka trajtuar pacientin S. Ç. dhe Shefi i Shërbimit të ORL-Okulistikë.

Mjeku specialist i cili ushtron detyrën e tij, për dhënien e Fletës së Drejtimit për KMCA, zbaton Ligjin Nr. 7703 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe është një detyrë jashtë funksioneve që ka mjeku specialist në Spital pasi fleta e drejtimit për KEMP kalon për zbatim dhe trajtim në Drejtorinë e Sigurimeve Shoqërore.

Mjeku Dr. A. K. referon se pacienti S. Ç. ka qenë i trajtuar me KEMP vite më parë dhe i është hequr së fundmi nga KEMP Epror, sipas mjekut është e drejtë e QSUT e cila ka lëshuar epikrizën përkatëse të lëshojë dhe fletën e drejtimit për KEMP, dhe s’ka pse të lëshohet epikrizë që janë të pavlefshme për KEMP. Pacienti është konstatuar nga mjeku duke lëvizur me Bicikletë në trafik, dhe sipas mjekut një pacient i cili vuan nga verbëria e ka të pa mundur të drejtojë bicikletën.

Gjatë egzaminimeve mjeksore pacientit i janë dhënë të gjitha shërbimet duke ndjekur të gjithë protokollin e mjekimit si dhe nuk është diskriminuar në asnjë rrethanë siç pretendon pacienti, ai është trajtuar pa asnjë lloj diskriminimi si të gjithë pacientët e tjerë që janë paraqitur për të marrë shërbim. Mjeku profesionalisht në bazë të egzaminimeve që ka kryer ndaj pacientit S. Ç. mendon se nuk i takon KEMP për aq sa ka konstatuar gjatë vizitave, gjithashtu pacienti ka të drejtë të trajtohet edhe nga mjekët e tjerë specialistë Okulistë që ka Spitali Korçë.

Për sa më sipër, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë, ju siguron së nuk kemi të bëjmë me asnjë lloj diskriminimi ndaj pacientit por procedura administrative që janë subjekt i Ligjit Nr. 7703 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, nuk rezulton asnjë rast diskriminimi në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Korçë”.

² Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1288/2 prot., datë 06.12.2023.

2. Komisioneri me anë të e-mail-it datë 07.12.2023, i përcolli subjektit ankues parashtrimet e Spitalit Rajonal Korçë dhe kërkoi parashtrime shtesë lidhur me to.

Në përgjigje të këtij e-maili, S. Ç., me e-mail-in datë 09.12.2023, informoi Komisionerin lidhur me pretendimet e tij sa i përket shkresës të sipërcituar, duke përcjell gjithashtu edhe disa dokumente sa i përket komisionimeve të bëra më parë nga KMCAP. Ndër të tjera ai theksoi se: “...Kempi më është prerë në vitin 2016, por unë nuk i dija rrugët ligjore që ta ndiqja, për këtë arsye jam shkëputur gjatë këtyre viteve duke më mbështetur një kompani e cila më pagoi kontributet e këtyre viteve, por në pamundësi për të më mbajtur akoma, unë iu drejtova përsëri doktorit okulist për të marrë kempin. Mjeku Okulist më dha fletën për të shkuar në Tiranë, për të kryer diagnostikimin në QSUT dhe mbas kryerjes së diagnostikimeve u ktheva përsëri te mjeku okulist Korçë për të marrë fletën e drejtimit për Kemp dhe ta dërgoja tek Sigurimet Shoqërore Korçë, por mjeku më tha që duhet të kalojnë 6 muaj nga heqja e kontributeve dhe më pas do të vish që të të pajis me fletë drejtimi. Kështu veprava dhe u paraqita përsëri. Këtë radhë më nxorri pretekstin se diagnostikimi është lëshuar 6 muaj para. Unë jam paraqitur përsëri në QSUT për të ndryshuar datën e epikrizës, por mjekët e QSUT më thanë që kjo fletë jepet vetëm 1 herë në vit dhe këtë gjë e di shumë mirë edhe mjeku i Korçës, por nuk e di arsyen nga se niset mjeku okulist i Korçës për mosdhënien e fletës së drejtimit për Kemp, në këtë rast unë ndihem i diskriminuar nga ana e mjekut.”

3. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës Nr. 1288/3 prot., datë 14.12.2023 iu drejtua sërish Spitalit Rajonal Korçë, si dhe kërkoi vënien në dispozicion të parashtrimeve lidhur me pretendimet e palës ankuese.

Me shkresën³ nr. 3 prot., datë 03.01.2024, Spitali Rajonal Korçë, sqaroi ndër të tjera se: “...Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë pasi mori kërkesën për informacion nga ana juaj për të kryer një hetim sa më të plotë, ju drejtua me shkresë zyrtare mjekut okulist Dr. A. K. për të dhënë një informacion në lidhje mesa kërkoni, gjithashtu ju drejtua me shkresë zyrtare Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë, e cila në datë 27.12.2023, na ka vënë në dispozicion praktikën dokumentare të dosjes së Kempit me nr. 130827/2, që i përket ankuesit S. R. Ç.

Nga sa referon mjeku bazuar në kërkesat tuaja rezulton të ketë ndryshim nga koha e komisionimit, sepse komisioni epror i ka hequr kempin ankuesit S. Ç. dhe se nuk ka pasur ndryshime. Ankuesi i është nënshtruar ekzaminimit dhe grupi i është hequr në përputhje me vendimin

e Komisionit Epror. Kur ankuesi është paraqitur për të kërkuar fletën e drejtimit për kemp ka marrë kontakt me mjekun tek hyrja e poliklinikës dhe se është paraqitur me biçikletë duke i kërkuar të pajiset me fletë drejtimi për kemp. Mjeku ka refuzuar duke ju drejtuar se një pacient që nget biçikletë

nuk është për përfitim të statusit me kemp, megjithatë për të qenë sa më korrekt i ka thënë ti nënshtrohet analizave më të detajuara pranë QSUT, si dhe ti mbushet fleta e drejtimit për kemp. Mjeku A. K. nuk është pjesë e komisionit të kempit dhe nuk mund të marrë attribute që janë në tejkallim të funksionit të tij.

³ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 20 prot., datë 08.01.2024.

Sipas dokumentacionit të depozituar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë rezulton se ankuesit S. Ç. i është refuzuar dhënia e kempit qysh në vitin 2009 me urdhër të Komisionit të Kempit Epror. Prej asaj kohe dhe deri tani nuk ka ndonjë ndryshim të gjendjes së tij shëndetësore në mënyrë që ky pacient të rikomisionohet dhe të kalojë përsëri në rikomisionim të Kempit Epror. Pra rezulton se vendimi për ndërprerjen e kempit është bërë disa herë nga Kemi Epror, i cili është organi kompetent për marrjen e vendimit për vazhdimin e kempit. Mjeku A. K. ka lëshuar më parë fletë dejetimin për në KMCAP, të cilat janë refuzuar nga KMCAP Epror dhe nga ai moment deri më tani, nuk ka asnjë ndryshim, pra jemi në një stad me refuzimin që ka bërë Kemi Epror. Gjatë kësaj periudhe, pacientit i është kërkuar që të kryejë ekzaminime pranë QSUT-së, si dhe fleta e drejtimit për në Kemp të mbushet në varësi të gjendjes shëndetësore nga QSUT.

Përsa më sipër ashtu siç ju kemi shpjeguar edhe në shkresën e mëparshme, referuar deklarimeve të mjekut dhe dokumentacionit përkatës, nuk rezulton që pacienti S. Ç. të jetë diskriminuar për shkak të gjendjes së tij shëndetësore. Nuk rezulton asnjë pacient i cili ka marrë shërbim pranë Spitalit Rajonal Korçë, që të jetë diskriminuar për shkak të gjendjes së tij shëndetësore...”.

4. Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 253, datë 06.02.2024, njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore.

Në vijim, S. Ç., më datë 08.02.2024, u paraqit pranë Zyrës Rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi Korçë dhe kërkoi pushimin e ankesës drejtuar Spitalit Rajonal Korçë, pasi çështja e tij kishte marrë zgjidhje, duke nënshkruar gjithashtu edhe Procesverbalin⁴ përkatës me të njëjtën datë.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

⁴ Kopja e tij është përcjell me anë të e-mail-it nga ana e Zyrës Rajonale të KMD-së Korçë dhe është administruar në dosje.

Në nenin 94⁵/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, S. Ç., i cili, me anë të kërkesës së përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 08.02.2024, është tërhequr nga ankesa e tij pranë KMD-së.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa e paraqitur nga subjekti ankues në datën 08.02.2024, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës me nr. 247 regj., datë 16.11.2023, të paraqitur nga S. Ç., kundër Spitalit Rajonal Korçë, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa dhe nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 247 Regj., datë 16.11.2023, paraqitur nga subjekti ankues S. Ç., kundër Spitalit Rajonal Korçë, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së, duke konsideruar se është arritur efektiviteti për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja shëndetësore dhe aftësia e kufizuar)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)

⁵ “Tërheqja e ankesës”.